



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 61006-00758-2020 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2020-486 i Vendimit**

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

Ilir PANDA	Kryesues
Sokol SADUSHI	Anëtar
Ervin PUPE	Anëtar

Sot në datë 24.12.2020 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen penale që i përket:

KËRKUES: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë.

KUNDËR:

1. Nejton Bali
2. Skënder Demiraj
3. Kludjo Zhilla
4. Arben Cara
5. Mimoza Margjeka.

OBJEKTI:

Caktim mase sigurimi personal ndaj shtetasit Nejton Bali të masës së sigurimit “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 e 25 i Kodit Penal.

Caktim mase sigurimi personal ndaj shtetasit Skënder Demiraj të masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 e 25 i Kodit Penal.

Caktim mase sigurimi personal ndaj shtetasit Kludjo Zhilla të masës së sigurimit “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë

të drejtësisë” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 e 25 i Kodit Penal.

Caktim mase sigurimi personal ndaj shtetasit Arben Cara të masës së sigurimit “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319/ç e 25 i Kodit Penal.

Caktim mase sigurimi personal ndaj shtetasës Mimoza Margjeka të masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319/ç e 25 i Kodit Penal.

Verifikimi i nevojave të sigurimit të të arrestuarit.

BAZA LIGJORE: Nenet 228, 229, 230, 232, 237, 238, 244, 248/1, 258 dhe 259 të Kodit të Procedurës Penale.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Ilir Panda dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka regjistruar në datë 09/07/2020, procedimin penal me nr. 186 të vitit 2020 për veprën penale “Ushttrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal. Ky procedim është regjistruar mbi informacionet e policisë gjyqësore, përfituar nga hetimi i një çështjeje, për një rast të mundshëm korrupsioni në organet e drejtësisë, konkretisht në Gjykatën e Apelit Korçë. Mbi informacionin policor, Prokuroria e Posaçme filloi hetimin dhe në funksion të tij u autorizuan përgjimet e bisedave të telefonave celularë në përdorim të të dyshuarve si dhe vëzhgimet e lëvizjes së tyre.

Në datën 03.08.2020, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale emrat e të hetuarve Nejton Bali, Klaudio Zhilla dhe Skënder Demiraj për kryerje në bashkëpunim të veprës penale të “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 e 25 i Kodit Penal, ndërsa shtetasit Arben Cara dhe Mimoza Margjeka për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319/ç e 25 i Kodit Penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të shtetasve Orion Bali banues në Farkë, Tiranë dhe Adi Mullalli fshatin Zëmlak, Maliq, si të dyshuar për veprën penale të "Ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve" parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal, gjatë hetimeve të të cilit, në datën 04/07/2020 ka arrestuar dhe të dyshuarit shtetasit Orion Bali dhe Adi Mullalli, për të cilët mbi kërkesën e Prokurorisë pranë saj,

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me vendimin nr. 115, datë 07/07/2020, ka caktuar masën e sigurimit "arrest në burg" ndaj tyre.

I hetuari Orion Bali në seancën gjyqësore të vleftësimit të arrestimit në flagrancë dhe caktimit të masës së sigurimit, ka pasur si mbrojtës të zgjedhur, avokatin Skënder Demiraj, anëtar i Dhomës Së Avokatisë Tiranë.

Shtetasi Skënder Demiraj, mbrojtës i të hetuarit Bali, i ka siguruar familjarët, konkretisht vëllain e të hetuarit, shtetasit Nejton Bali mundësinë e ndërhyrjes tek funksionarë të sistemit të drejtësisë, gjyqtarë, në Gjykatën e Apelit Korçë me qëllim të zbutjes së masës së sigurimit ndaj shtetasit Orion Bali, por kundrejt një shpërblimi monetar për gjyqtarët, në shumën prej 6 000 (gjashtë mijë) euro.

Shtetasi Nejton Bali pasi ka siguruar shumën monetare të kërkuar, ja ka dhënë ato shtetasit Skënder Demiraj. Ky i fundit, nga ana tjetër ka vendosur komunikime me disa shtetas nga qyteti i Korçës dhe nga shtetasi Kludjo Zhilla i është siguruar mundësia e ndërhyrjes tek gjyqtarët Olsi Xhavella dhe Mimoza Margjeka Për shkak të njohjeve personale që kishte me shtetasin Olsi Xhavella dhe me bashkëshortin e gjyqtarës Mimoza Margjeka, shtetasin Arben Cara.

Shtetasi Kludjo Zhilla ka vijuar përmbushjen e premtimit të tij, duke komunikuar dhe takuar vetë shtetasin Arben Cara dhe më pas duke ndërmjetësuar dhe mundësuar takimin e tij me shtetasin Skënder Demiraj. Shtetasi Skënder Demiraj i ka dhënë shtetasit Arben Cara shumën prej 6 000n

(gjashtë mijë) eurosh me qëllim zbutjen e masës së Sigurimit të "arrestit në burg" ndaj shtetasit Orion Bali, periudhë pas së cilës ka vijuar takimet me shtetasin Kludjo Zhilla, Arben Cara dhe gjyqtarën Mimoza Margjeka.

Shtetasi Nejton Bali, vëllai i Orionit, pas komunikimeve me mbrojtësin, avokatin Skënder Demiraj, ka njoftuar duke siguruar, të ëmën se shuma monetare u është dhënë gjyqtarëve dhe masa e sigurimit ndaj Orionit do të ndryshohej nga "arrest në burg" në "garanci pasurore" premtim që është bërë real me vendimin nr. 110, datë 29/07/2020, të Gjykatës së Apelit Korçë.

2. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 92, datë 05.09.2020, ka vendosur:

Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Caktimin ndaj personit nën hetim Nejton Bali, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë" kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 319 e 25 i Kodit Penal, të masës së sigurimit: "*arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Caktimin ndaj personit nën hetim Skënder Demiraj, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë" kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 319 e 25 i Kodit Penal, të masës së sigurimit: "*arrest në shtëpi*", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, me të cilin urdhëron të hetuarin Skënder Demiraj të mos largohet nga banesa e tij si dhe të mos komunikojë me persona të tjerë me përjashtim të atyre që bashkëjetojnë me të.

Caktimin ndaj personit nën hetim Kludjo Zhilla, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë" kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 319 e 25 i Kodit Penal, të masës së sigurimit: "*arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Caktimin ndaj personit nën hetim Arben Cara, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë" kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 319/ç e 25 i Kodit Penal, të masës së sigurimit: "*arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Caktimin ndaj personit nën hetim Mimoza Margjeka, e dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë" kryer në

bashkëpunim, të parashikuar nga neni 319/ç e 25 i Kodit Penal, të masës së sigurimit: “*arrest në shtëpi*”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, me të cilin urdhëron të hetuarin Skënder Demiraj të mos largohet nga banesa e tij si dhe të mos komunikojë me persona të tjerë me përjashtim të atyre që bashkëjetojnë me të.

Urdhërohet Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Policia Gjyqësore pranë saj si dhe Policia Gjyqësore Pranë Drejtorisë Vendore përkatëse për ekzekutimin e këtij vendimi dhe kontrollimin e zbatimit të urdhrave dhënë të hetuarve nga kjo gjykatë.

Kundër këtij vendimi lejohet e drejta e ankimit Brenda afatit ligjor në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar në arsyetimin e saj ndër të tjera ka shpjeguar:

Mbi këto të dhëna të përfuara nga provat e shqyrtuara në këtë kërkesë e konkretisht: procesverbalet e transkriptimit të bisedave telefonike të përgjuara lejuar dhe vleftësuar nga kjo Gjykatë si gjykata e hetimit paraprak dhe procesverbalet e vëzhgimit të fshehtë të autorizuar nga prokurorja, të datave 09/07/2020, 10/07/2020, 21/07/2020, 22/07/2020, 23/07/2020, 24/07/2020, 28/07/2020, 29/07/2020, akteve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, që lidhen me masën e sigurimit ndaj të hetuarit Orion Bali dhe disponimet e vendimeve më të cilat është cënuar liria e tij, ku përfshihet dhe dispozitivi i vendimit nr. 110, datë 29/07/2020 të Gjykatës së Apelit Korçë më të cilin është zëvendësuar masa e sigurimit ndaj tij nga “arrest në burg”, në “garanci pasurore” si dhe akteve të tjera që konfirmojnë të dhënat identifikuese të autorëve dhe rrethana të ngjarjes, kjo gjykatë konkludon se ka dyshime të arsyeshme të bazuar në prova se të hetuarit Nejton Bali, Skënder Demiraj dhe Klaudio Zhilla kanë kryer me veprime aktive, në bashkëpunim mes tyre veprën penale të “Korrupsionit aktiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga nenet 319 e 25 të Kodit Penal duke i ofruar një shumë monetare si përfitim të parregullt gjyqtarës Mimoza Margjeka në këmbim të zbutjes së masës së sigurimit ndaj të hetuarit Orion Bali.

Kjo e fundit e komanduar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Apelit Korçë në bashkëpunim me bashkëshortin e saj, shtetasin Arben Cara ka pranuar një shumë monetare të marrë si përfitim të padrejtë kundrejt marrjes gjatë detyrës së saj të gjyqtarës të vendimit për zbutjen e masës së sigurimit ndaj të hetuarit nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec shtetasit Orion Bali.

3. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar, me vendimin nr. 94, datë 05.09.2020, “Mbi marrjen në pyetje dhe verifikimin e nevojave të sigurimit të të arrestuarve” ka vendosur:

Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “arrest në burg”aktuar ndaj të hetuarve Nejton Bali, Klaudio Zhilla dhe Arben Cara dhe “arrest në shtëpi”aktuar ndaj të hetuarve Skënder Demiri dhe Mimoza Margjeka, me vendimin nr. 92 datë 05.09.2020 të gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar.

Kjo gjykatë në lidhje me vijimin e zbatimit të masave të sigurimit të caktuar me vendimin me nr.92 datë 05.09.2020 në arsyetimin e saj ndër të tjera ka shpjeguar:

Nga të dhënat e akteve dhe provave të shqyrtuara si procesverbale të transkriptimit të bisedave telefonike të përgjuara, lëvizjeve të të hetuarve dokumentuar në vëzhgim policor dhe akteve shkresore, kjo gjykatë në mbështetje të nenit 228/1 të Kodit të Procedurës Penale vlerëson se vazhdojnë të mbeten të njëjtat dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se të hetuarit Nejton Bali, Klaudio Zhilla dhe Skënder Demiraj në bashkëpunim mes tyre të kenë kryer veprën penale të “Korrupsionit aktiv të gjyqtarit, prokurorit dhe të funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar

nga nenet 319 e 25 të Kodit Penal, ndërsa shtetasit Arben Cara dhe Mimoza Margjeka, kjo e fundit në funksionin e gjyqtarës në bashkëpunim mes tyre kanë kryer veprën penale "Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë" të parashikuar nga nenet 319/ç e 25 i Kodit Penal, vepra penale për të cilat janë nën hetim nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Kjo gjykatë në mungesë të rrethanave objektive që i vlerëson ta pandryshuara edhe pas kalimit të afatit 3-ditor, parashikuar nga neni 248 i Kodit të procedurës penale dhe marrjes në pyetje të vetë të arrestuarve, vlerëson se nuk ka vend për të ndryshuar vendimmarrjen nr. 92 datë 05/09/2020 të kësaj Gjykate (si gjyqtare e hetimeve paraprake).

Deklarimet e dhëna gjatë marrjes në pyetje, sipas parashikimit të nenit 248/1 të Kodit të procedurës penale të të hetuarve Skënder Demiraj dhe Arben Cara kjo gjykatë i gjen në kundërshtim me provat e mbledhura gjatë hetimit, sipas të cilave takimi mes tyre me ndërmjetësinë e të hetuarit Klaudio Zhillës nuk ka qenë rastësor.

Të dhënat e përfuara nga biseda e përgjuar e datës 28/07/2020, ora 19:21 i japin informacioni kësaj gjykate se i hetuari Demiraj ishte në pritje të telefonatës së Klaudio (Klodi) për të takuar të hetuarin Arben Cara dhe ka ndenjur në shoqërinë e tij dhe të Klodit në Restorantin "Te Eleni", që ndodhet në bodrum të Hotel "Pazarit" deri në orën 21.11. Këtë fakt ja konfirmon të hetuarit Nejton edhe Skënderi në komunikimin telefonik mes tyre, atë mbrëmje të datës 28.07.2020 ora 20.10 ky i fundit i thotë se "*u shkëput dy min*".

Të dhënat e përfuara nga përgjimet telefonike, vlerësuar të lidhura me vëzhgimet policore në terren dyshuarve i konfirmojnë kësaj gjykate se tre të hetuarit Zhilla, Demiri dhe Cara janë takuar përsëri në datën 29/07/2020 në orën 10:36 dhe kanë qëndruar në Restorantin "Te Eleni" deri në orën 11:00. Po nga të dhënat e vëzhgimeve në terren të lëvizjes së të dyshuarve kjo gjykatë përfiton informacionin se e hetuara Mimoza Margjeka ka shkuar dhe është ulur në Bar-Kafe "Cozy" ku ka qenë bashkëshorti i saj Arben dhe i hetuari Klaudio Zhilla për rreth 10 min, Bar-Kafe që nuk ndodhet në Restorantin e Hotelit në pronësi të Klaudio (Klodit) siç deklaroi e hetuara Margjeka.

Duke vlerësuar të dhënat e përfuara nga komunikimet telefonike dhe vëzhgimet në raport me deklaratimet e të hetuarve Demiraj, Cara, Margjeka, të cilat nuk janë në harmoni mes tyre, por përkundrazi bien në kundërshtim me të dhënat e përfuara, kjo gjykatë ndan të njëjtin vlerësim mbi faktet dhe veprimet e të dyshuarve, si vendimmarrja e saj nr.92, datë 05/09/2020.

Kjo gjykatë në përputhje me nenin 228/3, pikat a, b dhe c të Kodit të Procedurës Penale nisur nga rrethanat e provuara dhe personalitetit të të hetuarve Nejton Bali, Klaudio Zhilla e Arben Cara, vlerëson se ekziston efektivisht rreziku i ikjes, rreziku i "ndotjes së provave prej tyre" dhe rreziku i kryerjes së veprave të tjera penale prej tij (të të njëjtit lloj ose më të rënda).

Për këtë arsye të hetuarit Nejton Bali, Klaudio Zhilla e Arben duhet të vijojnë t'i nënshtrohen një mase sigurimi personal, që nisur nga shkalla e nevojave të sigurimit, rëndësisë së faktit, sanksionit që parashikohet në dispozitat përkatëse nenet 319, 319/g dhe 25 të Kodit Penal dhe personalitetit të të hetuarve që janë përfshirë në një veprimtari të tillë kriminale që cënon organet e drejtësisë me efekt në të gjithë funksionin shtetëror dhe jetën në vend, kjo gjykatë vlerëson se duhet të vijojë të jetë masa e sigurimit personal me efekt shtrëngues e parashikuar nga neni 238 i Kodit të procedurës penale, ajo e "arrestit në burg" pasi çdo masë tjetër sigurimi është e papërshtatshme nisur nga rrezikshmëria e veçantë e veprës penale dhe e të pandehurve.

Lidhur me kërkimin e mbrojtësve Gjeta, Ibraj dhe Ilia për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj të mbrojturve prej tyre, mbi rrethanat familjare të tyre dhe ato shëndetësore, kjo gjykatë vlerëson se për shkak të rëndësisë së faktit për të cilën hetohen dhe rrethanave të ngjarjes, këto shkaqe të pretenduara (të paprovuara me asnjë akt për të hetuarin Arben Cara, me akte të pakonfirmuara për rrezikun e jetës për të hetuarit Bali e Zhilla) janë paefekt në zbutjen e nevojave

të sigurimit të tyre, duke lënë në vlerësim të kësaj gjykatë, në kushtet e vazhdimësisë masën e sigurimit "arrestit në burg".

Edhe për të hetuarit Demiraj e Margjeka do të vijojë të zbatohet në vlerësim të kësaj gjykate e njëjta masë sigurimi "arrest në shtëpi", nisur nga rrethanat personale të tyre (mosha për të hetuarin Demiraj dhe fëmija i mitur për të hetuarën Margjeka), mbajtur më konsideratë nga kjo gjykatë edhe në vendim marrjen nr.92, datë 05/09/2020 të saj.

Kjo gjykatë edhe pas marrjes në pyetje personalisht të të hetuarve Demiraj dhe Margjeka në përputhje me parashikimin e nenit 248/1 të Kodit të procedurës penale dhe dëgjimit të rrethanave të ngjarjes prej tyre, nuk ndryshon vlerësimin e saj mbi faktet dhe veprimet e tyre duke mos gjetur të bazuar as kërkimet e tyre dhe të mbrojtësve Rusi dhe Gjokutaj për zbutjen e masës së sigurimit personal ndaj tyre.

4. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 29, datë 01.10.2020, ka vendosur:

Miratimin e vendimeve nr. 92 datë 05.09.2020 dhe nr. 94 datë 12.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në arsyetimin e saj ndër të tjera ka shpjeguar:

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Pare, ka vlerësuar drejt provat dhe kërkesat e ligjit, duke caktuar ndaj secilit shtetas nën hetim, masën e sigurimit "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale (Nejton Bali, Kludjo Zhilla e Arben Cara) dhe masën e sigurimit "Arrest në shtëpi" parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale për të hetuarit Skënder Demiraj e Mimoza Margjeka. Në këtë vështrim, tërësia e provave të marra e të verifikuara gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë, edhe Gjykata e Posaçme e Apelit, vlerëson se shkaqet e ngritura në ankim nga ana e mbrojtësve që janë trajtuar në analizën e provave në të dy vendimet nr. 92, date 05.09.2020 dhe nr. 94, datë 12.09.2020 e do të trajtohen në vijim, për shfuqizimin apo ndryshimin e llojit të masës së sigurimit të caktuar, nuk janë të bazuara si në fakt ashtu dhe në ligj, ndaj disponimi i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, në të dy vendimet duhet miratuar, përse janë ankimuar.

Ndryshe nga sa pretendojnë mbrojtësit dhe të hetuarit, Gjykata e Posaçme Apelit çmon se Gjykata e Posaçme e Shkallës së pare ka vlerësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenet 228, 229 dhe 230 të K. Pr. Penale.

Gjykata e Posaçme e Apelit çmon se ndaj shtetasve nën hetim (Nejton Bali, Kludjo Zhilla e Arben Cara) mbi aktet e cituara e të analizuar, ekziston një dyshim i arsyeshëm, mbështetur në prova dhe aktet e analizuar, për kryerjen e veprave penale që i atribuohen. Ky kolegji vlerëson se provat e analizuar në këtë vendim janë të mjaftueshme për të justifikuar dyshimin e arsyeshëm që shtetasit nën hetim të kenë janë përfshirë në kryerjen e veprave penale.

-Ky Kolegj vlerëson se veprimet e secilit prej të hetuarve nuk duhet të të veçohen e të vlerësohen të shkëputura nga njeri-tjetri, e në vlerësimin e Gjykatës së Posaçme të Apelit, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova mbi faktin e implikimit në korrupsion aktiv dhe pasiv. Rezulton e provuar jo vetëm nga transkriptimet e bisedave telefonike të përgjuara të autorizuara nga prokuroria e gjykatat, por edhe nga të dhënat e përfituara nga vëzhgimet në vijimësi prej rreth 1 muaj kur ka filluar procedimi në raport me bisedat telefonike, nga të dhënat e dokumentimit të këqyrjes mbi vëzhgimin e fshehtë të personave dhe mjediseve ku janë fiksuar lëvizjet e takimet mes të hetuarve.

Kolegji i gjykatës së Apelit çmon se është i drejtë vendimi i gjykatës së hetimit paraprakë në lidhje me caktimin e masës së sigurimit, për të gjithë të hetuarit sepse gjenden të plotësuar kushti i parë, i dytë dhe i tretë i përcaktuar nga neni 228 i K. Pr. Penale, për caktimin e masës së sigurimit.

Nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë është argumentuar në lidhje me *periculum libertatis*, për secilin të hetuar nën masën e sigurimit arrest në burg/shtëpi, argumente të cilat ky Kolegj i konfirmon plotësisht. Megjithatë, Gjykata e Posaçme e Apelit çmon të shtojë se, lidhjet dhe njohjet për të cilat të hetuarit dyshohet të kenë në kontekstin kriminal objekt i shqyrtimit tregon që është veçanërisht konkret dhe aktual rreziku se të hetuarit nëse lihen të lirë apo me një masë tjetër sigurimi të vazhdojnë veprimtarinë e paligjshme, si dhe me mundësinë për krijimin e pengesave në zbulimin e plotë të rrethanave e mekanizmit në kryerjen e veprës penale.

Në vazhdim të hetimeve në lidhje me këtë procedim penal, është e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera procedurale, duke i verifikuar dhe analizuar ato në raport edhe me prova të tjera, për të arritur në konkluzione të drejta në lidhje me fajësinë e secilit prej çdo dyshimi të përfshirë në këtë fakt; si dhe në analizë të mekanizmit të kryerjes e rolit të secilit në këtë veprimtari kriminale.

Në trajtim të shkakut të paraqitur mbi shfuqizimin apo ndryshimet e masës "Arrest në burg" në "Arrest në shtëpi" apo nga kjo e fundit "Detyrim për tu paraqitur policinë gjyqësore" ngritur nga mbrojtësit e hetuarve, që kanë ankimuar kjo gjykatë thekson se, parimi i proporcionalitetit dhe i përshtatshmërisë, i përcaktuar nga ligjvënësi në nenin 229 të K. Pr. Penale, vjen në raport të vlerësimit të masave të sigurimit me nevojat siguruese specifike të rastit konkret në momentin e zgjedhjes dhe urdhërimit të masës shtrënguese.

-Në vlerësimin e gjykatës së apelit faktet e pretenduara nga mbrojtësit nuk hedhin poshtë provat e analizuara në këtë vendim. Mënyra dhe dinamika e zhvillimit të kësaj ngjarje ka çuar në zbulimin e identifikimin të disa prej të dyshuarve që edhe janë caktuar masat e sigurimit edhe pas vëzhgimit nga policia e përgjimit të komunikimeve, në bazë të vendimeve të gjykatës cituar në vendimin objekt ankimi të organit të akuzës e gjykatës, sipërcituar. Sa më lart krijon bindjen tek kjo gjykatë se, lënia e lirë e secilit të dyshuar jo vetëm që mund të pengojë zbardhjen e plotë të rrethanave të kryerjes së kësaj veprë penale, por ekziston edhe mundësia që të largohen e t'i fshihen hetimit e gjykimit siç u arsyetua më lart, ndaj duke i konsideruar të drejta edhe argumentimin për secilin të hetuar në seancën e datës 12.09.2020 mbi shkaqet e pretenduara nga mbrojtësit ky kolegj e çmon se ky vendim është i drejtë dhe si i tillë duhet të miratohet. Njëkohësisht, parashtrimet e mbrojtësve dhe aktet e paraqitura, për rrethanat familjare e shëndetësore të personave nën hetim, cituar në aktin ankim e parashtruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi, gjykata në këtë moment nuk i konsideron të tilla që të çojnë në ndryshimin e masës së sigurimit në këtë gjykim. Duke i konsideruar të drejta edhe argumentimin për secilin të hetuar, në seancën e datës 12.09.2020 mbi shkaqet e pretenduara nga mbrojtësit, ky kolegj e çmon se vendimi nr. 92, datë 05.09.2020 si dhe vendimi nr 94 datë 12.09.2020 janë të drejtë dhe si të tillë duhet të miratohen.

5. Kundër vendimit me nr. 29, datë 01.10.2020, të Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka paraqitur rekurs më datë 06.10.2020, personi nën hetim Kaludjo Zhilla me të cilin ka kërkuar: "*Ndryshimin e vendimit nr. 92 datë 05.09.2020 dhënë nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe vendimi nr. 29 datë 01.10.2020 të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duke përcaktuar për personin nën hetim Klaudio Zhilla si masë sigurimi atë të detyrimit për tu paraqitur parashikuar nga neni 234 i K. Pr. Penale*", duke pretenduar këto shkaqe:

U provua tej çdo dyshimi se i mbrojturi prej nesh as ka përfituar, as ka ndërmjetësuar, as ka dhënë dhe as ka premtuar. Nuk ka marre dhe as ka pasur interes për çështjen.

Vendimet e mësipërme janë marr në shkelje të ligjit material dhe atij procedural pasi nuk ka lidhje me asnjë veprë për të cilën akuzohet dhe nuk gjenden të përmbushura kushtet dhe kriteret që kërkohen nga neni 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka asnjë prove e cila mund të bazohet dyshimi i arsyeshem me qëllim caktimin e një mase sigurimi.

6. Kundër vendimit me nr. 29, datë 01.10.2020, të Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka paraqitur rekurs më datë 10.10.2020, personi nën hetim Nejton Bali me të cilin ka kërkuar:

Ndryshimin e vendimit nr.92 datë 05.09.2020 dhënë nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kushtet dhe kritere të këtij vendimi të verifikuara me vendimin nr. 94 datë 12.09.2020 të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ndryshimin e vendimit nr. 29 datë 01.10.2020 të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për atë që ka të bëjë me masën e sigurimit “arrest në burg” të vendosur ndaj të dyshuarit Nejton Bali.

Aplikimin e një mase sigurimi me të butë ose detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, duke pretenduar këto shkaqe:

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar rezulton të ketë bërë zbatim dhe interpretim të gabuar të ligjit procedural penal, konkretisht nenet 228, 229 dhe 230 të K. Pr. Penale të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm, që ky shtetas të ketë konsumuar veprën penale për të cilën ai është nën hetim, si dhe me praktikën unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për vërtetimin e ekzistencës së kushteve për të cila aplikohet masa e sigurimit “arrest në burg”.

Vendimet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe Gjykatës së Posaçme Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vijnë në kundërshtim me praktikën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendimet Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, konkretisht vendimi nr. 3 datë 27.09.2002, nr. 1 datë 08.01.2009, nr.7 datë 14.10.2011.

Përgjimet telefonike të paraqitura nga organi i akuzës në përmbajtjen të tyre nuk provojnë asnjë implikim të këtij të dyshuari, në veprat penale për të cilën ai është nën hetim.

U provua tej çdo dyshimi se i mbrojturi prej nesh as ka përfituar, as ka ndërmjetësuar, as ka dhënë dhe as ka premtuar. Nuk ka marre dhe as ka pasur interes për çështjen.

Gjykata e Lartë në momentin e shqyrtimit të këtij rekursi, për aplikimin e masës së sigurimit personal të të dyshuarit Nejton Bali duhet të mbajë parasysh rrethanat si më poshtë: fakti që ky shtetas është i padënuar; fakti që ka sjellje të mirë në komunitet; fakti që ka përgjegjësi familjare; fakti që ka probleme të rënda shëndetësore.

7. Kundër vendimit me nr. 29, datë 01.10.2020, të Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka paraqitur rekurs më datë 26.10.2020, personi nën hetim Skënder Demiraj me të cilin ka kërkuar:

Shfuqizimin e vendimit nr. 29 datë 01.10.2020 të Gjykatës Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe të vendimit nr. 92 datë 05.09.2020 të gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar verifikuar më datë 12.09.2020 duke rrëzuar kërkesën për masën e sigurimit personal “arrest shtëpie”, nëse Gjykata e Lartë nuk bindet të mbajë këtë qëndrim, të vendos ndryshimin e vendimit objekt rekursi, duke caktuar masë sigurimi ndaj rekursuesit S.Demiraj, atë të “Detyrimit për tu paraqitur para oficerit të policisë gjyqësore”parashikuar nga neni 23 të K. Pr. Penale”, duke pretenduar këto shkaqe:

Vendimet e mësipërme janë marr në shkelje të ligjit material dhe atij procedural pasi nuk ka lidhje me asnjë vepër për të cilën akuzohet dhe nuk gjenden të përmbushura kushtet dhe kriteret që kërkohen nga neni 228 dhe 229 të Kodi të Procedurës Penale, pasi nuk ka asnjë prove e cila mund të bazohet dyshimi i arsyeshëm me qëllim caktimin e një mase sigurimi.

Gjykata kanë gabuar duke vendosur masë sigurimi “arrest në shtëpi” për rekursuesin pasi ai ka qenë vetëm në detyrën e përmbushjes së funksionit ligjor dhe kushtetues si mbrojtës, i cili ka ardhur në institutin e mbrojtjes, duke qenë një figurë e spikatur në organin e prokurorisë.

Gjykata e Posaçme e Apelit duhet të ndryshonte vendimin e shkallës së parë për shkak të moshës të thyer gati 70 vjeç dhe veçanërisht akteve shëndetësore që ju bënë prezent në seancë.

Gjykata e Lartë i ka të gjitha kushtet ligjore dhe mundësitë të zëvendësoj masën e sigurimit duke pranuar rekursin për shkak së vazhdimi i arrestit në shtëpi do të pengonte interventin apo trajtimin e specializuar në spitale apo klinika private dhe rekursi përmban kriteret e nenit 432/c e K. Pr. Penale pasi vendimi i apelit bie ndesh me praktiken e Kolegjit Penal të gjykatës së Lartë, e cila në shumë raste ka mbajtur qëndrim pa pasur as edhe këtë situatë pandemie globale dhe rastin specifik të akteve normative e cila e mundëson gjykatën të pranoj rekursin duke zëvendësuar masën e sigurimit, kërkesë e cila është në union dhe me praktikën gjyqësore.

8. Kundër vendimit me nr. 29, datë 01.10.2020, të Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka paraqitur rekurs më datë 12.11.2020, personi nën hetim Mimoza Margjeka me të cilin ka kërkuar:

Ndryshimin e vendimit nr. 94 datë 12.09.2020 pranë Gjykatës Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar lënë në fuqi me vendimin nr. 29 datë 01.10.2020 të Gjykatës Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Heqjen e masës sigurimit personal ndaj Mimoza Margjeka të “Arrestit në shtëpi”parashikuar nga neni 237 i K. Pr. Penale dhe hetimin e saj në gjendje të lirë”, duke pretenduar këto shkaqe:

Përgjimi telefonik i datës 07.07.2020 midis shtetasit Nejton Bali dhe Afërdita Bali është përgjim parandalues i mbështetur në nenin 23 të ligjit nr. 9157 datë 04.12.2003 “Për përgjimin e telekomunikimeve”, rezultatet e të cilit nuk mund të përdoren si provë referuar Nenit 221/5 të K. Pr. Penale. ky përgjim është i papërdorshëm dhe sepse nuk janë respektuar kërkesat e nenit 222/2 të K. Pr. Penale, pasi mungon vlerësimi i gjykatës. Nëse ky vlerësim nuk bëhet brenda 24 orëve, sipas këtij neni “përgjimi nuk mund të vazhdojë dhe rezultatet e tij nuk mund të përdoren”aq më tepër kur ky vendim mungon fare.

Përgjimet në vendet publike të datës 29.07.2020, rezulton se janë survejuar shtetasit Mimoza Margjeka dhe Arben Cara, dhe nga ana e prokurorit për këto vëzhgime nuk ka fare autorizim, duke vepruar kështu prej OPGJ-së në kundërshtim me nenin 221/2 dhe 228/8 të K. Pr. Penale, duke i bërë këto prova të papërdorshme sipas nenit 151/1,3 e 226 të K. Pr. Penale.

Në lidhje me përgjimet telefonike, rezulton se nga prokuroria janë marrë 10 vendime për lejim, (autorizimin) e përgjimit telefonik të komunikimeve hyrëse dhe dalëse për të cilat është bërë kërkesa për vleftësim në Gjykatë, por vetëm për njërin nga këto ndodhet vendimi gjyqësor për vleftësimin e përgjimit të datës 19.07.2020. për asnjë vendim tjetër të Prokurorit nuk ka vlerësim përgjimi nga Gjykata. Për rrjedhojë nuk ka respektuar kërkesat e nenit 222/2 të K. Pr. Penale i cili brenda 24 orëve duhet ti dërgonte gjykatës, e cila brenda 24 orëve duhet të bënte vlerësimin dhe të dilte me vendimin përkatës. Edhe këto përgjime telefonike si vëzhgimet audio janë të papërdorshme dhe të tilla duhet të konsiderohen nga kjo gjykatë. Megjithatë edhe nëse këto përgjime telefonike dhe video në vende publike të analizuarra në pjesën e parë të këtij ankimi do të konsideroheshin të përdorshme, janë indicie dhe nuk provojnë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm (neni 152/2 i K. Pr. Penale), në të kundërtën, nëse do të transkriptohehin të gjitha do të provojnë katërcipërisht pafajësinë e Z.Cara dhe Znj. Margjeka.

Ky vendim bie në kundërshtim me K. Pr. Penale, praktikën e KDEGJ-së, Gjykatës së Lartë. Gjykata e Apelit ka rënduar padrejtësisht pozitën e personit nën hetim Mimoza Margjeka duke e bërë fajtorë, para se të jetë provuar fajësia e saj, e si rrjedhojë ka sjellë si pasojë heqjen e lirisë dhe vendosjen e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”ndaj saj.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të vlerësoj se në vendosjen e masës së sigurimit personal nuk janë marrë parasysh të gjitha kushtet e përcaktuara nga ligji për këtë qëllim konkretisht neni 228, 229 dhe 230 i K. Pr. Penale. Referuar fakteve dhe rrethanave të pretenduara në këtë gjykim, duhet të çmojë se jemi para rastit kur nuk mund të vendoset masë sigurimi, por edhe nëse çmohet prej kësaj gjykate vendosja e një mase sigurimi, të vendoset një masë tjetër më e butë referuar nenit 248/2 dhe 260 të K. Pr. Penale. Kështu kufizimet ndaj të drejtës për liri duhet të shihet si të jashtëzakonshëm dhe duhen lejuar vetëm kur vendimi i gjykatës jep një justifikim bindës.

Gjykata e Lartë duhet të marrë në konsideratë që mos të caktohet masë sigurimi pasi personi nuk ka rrezikshmëri shoqërore, ka ushtruar detyra të rëndësishme shtetërore, ka qenë gjyqtare, familjare e rregullt dhe me përgjegjësi e një prindi me një fëmijë 3 vjeçar, si edhe ka bashkëshortin me një masë sigurimi të rëndë. Qëndrimi i saj me masë sigurimi “arrest në shtëpi” e pengon në përmbushjen e detyrave të nënës ndaj një fëmije që është në proces edukativ, kujdes shëndetësor, fizik dhe kulturor.

9. Kundër vendimit me nr. 29, datë 01.10.2020, të Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka paraqitur rekurs më datë 13.11.2020, personi nën hetim Arben Cara me të cilin ka kërkuar:

Shfuqizimin i vendimit nr. 29 datë 01.10.2020 të Gjykatës Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që ka miratuar vendimet nr. 92 datë 05.09.2020 pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në lidhje me caktimin e masës shtrënguese të “arrestit në burg” ndaj rekursuesit; nr. 94 datë 12.09.2020 pranë Gjykatës Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në lidhje me pyetjen e të arrestuarit dhe vazhdimin e mbajtjes së masës shtrënguese të “arrestit në burg” ndaj rekursuesit, si të pabazuara në prova e ligj, ose ndryshimin e atyre vendimeve duke caktuar një masë shtrënguese me të lehtë nga ajo e “arrestit në burg”, duke pretenduar ndër të tjera këto shkaqe:

Në vlerësimin tonë si mbrojtje pretendimet formësojnë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal me pasojë papërdorshmërinë e provave dhe rrjedhimisht pavlefshmërinë e vendimit. Përgjimi telefonik i datës 07.07.2020 midis shtetasit Nejtun Bali dhe Afërdita Bali është përgjim parandalues i mbështetur në nenin 23 të ligjit nr. 9157 datë 04.12.2003 “Për përgjimin e telekomunikimeve”, rezultatet e të cilit nuk mund të përdoren si provë referuar Nenit 221/5 të K. Pr. Penale. Ky përgjim është i papërdorshëm dhe sepse nuk janë respektuar kërkesat e nenit 222/2 të K. Pr. Penale, pasi mungon vlerësimi i gjykatës. Nëse ky vlerësim nuk bëhet brenda 24 orëve, sipas këtij neni “përgjimi nuk mund të vazhdojë dhe rezultatet e tij nuk mund të përdoren” aq më tepër kur ky vendim mungon fare. Ky vendim nuk rezulton të jetë gjetur dhe marrë nga OPGJ-ja me gjithë urdhërimin e bërë nga Prokuroria Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Mos depozitimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për lejimin e përgjimit dhe mos qenia e tij pjesë e fashikullit të hetimit të nisur nga Prokuroria e Posaçme nuk mund të motivohet me asnjë qëndrim ligjor, pasi nga ana jonë me vënien në dijeni të përgjimit me të drejtë kërkojmë që të na vihet në dispozicion, mosvënien e të cilit dedukton në rezultatin që ky vendim nuk ekziston dhe përgjimi është i paligjshëm.

Provat e marra nuk bazohen në burime sipas ligjit procedural penal, për shkak të papërdorshmërisë së tyre. Por edhe nëse pranojmë që provat në fjalë janë në përputhje me ligjin, evidentohet se ato nuk kanë kapacitetet provues që të përligjin ekzistencën e dyshimit për Arben Cara. Sipas nenit 228/1 të K. Pr. Penale prokuroria nuk arrin të provojë dyshimin e arsyeshëm i bazuar në prova, dhe gjykata duhet të arsyetoj dhe analizojë ekzistencën e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit që t’i krijojnë bindje gjykatës në drejtim të mundësisë që personi nën hetim dhe i pandehuri të ketë kryer veprën penale. Për rrjedhojë, për caktimin e masës së sigurimit është e

nevojshme që provat direkte apo indirekte, të jenë të tilla që të bëjnë të duket e mundshme përgjegjësia e të hetuarit.

Nga provat e administruara edhe pse transkriptimi i përgjimeve nuk është bërë i gjithi, nga i cili na rezulton se ka disa biseda ku Klodian Zhilla konfirmon në datë 24.07.2020 pra një javë përpara vendimmarrjes gjyqësore se nuk e ka takuar Benin dhe se ky i fundit do të vinte të martën, pra në datë 28.07.2020 një ditë përpara gjykimit.

Gjykata përpos mos arsytimit të kushteve të përcaktuara nga neni 228 i Kodit të Procedurës Penale nuk ka analizuar asnjë element të kriterit të veçantë, duke anashkaluar personalitetin e tij si akademik, asnjëherë i dënuar, me kontribute shoqërorë, pa asnjë rrezik ikje e cenim provash e aq më tepër kryerjen e fakteve të tjera penale.

Ky vendim është në kontradiktë të hapur me praktikën e mbajtur nga Kolegji penal i gjykatës së Lartë e cila me vendimin nr. 163 datë 12.01.2017 ka zëvendësuar masën e sigurimit personal për shtetasin O.A., i akuzuar së bashku me bashkëshorten e tij për të njëjtën vepër penale që akuzohen edhe i mbrojturi prej meje.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

10. Rekurset nga personat nën hetim Nejton Bali, Skënder Demiraj, Klaudjo Zhilla, Arben Cara, Mimoza Margjeka dhe janë paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale. Prokurori pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe personat nën hetim janë njoftuar për rekursin nëpërmjet dëftesës së komunikimit.

11. Neni 432 i Kodit të Procedurës Penale, në pikën 1 të tij, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

12. Kolegji vlerëson se gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të personave nën hetim Mimoza Margjeka, Arben Cara, Nejton Bali, Klaudjo Zhilla dhe Skënder Demiraj për shkelje të ligjit procedural penal, neneve 228, 229, 230 dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale të riparaqitura si shkaqe edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Kolegji sjell në vëmendje se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Qëndrimi që mban Kolegji për rastin në shqyrtim, bazohet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që referon në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave shkaqet e parashtruara në rekurs që rezultojnë haptazi të pabazuara vlerësohen si të papranueshme për pranimin e rekursit.

13. Kërkimi për papërdorshmërinë e provave që ngrejnë në rekurs personat nën hetim Mimoza Margjeka dhe Arben Cara rezulton se është ngritur vetëm në rekurs pa pasur një kërkim të tillë si gjatë verifikimit të kushteve të zbatimit të masës së sigurimit ashtu edhe në apelimin që është kryer ndaj caktimit të kësaj mase sigurimi personal. Gjykatat e faktit nuk janë shprehur në lidhje me këtë kërkim pasi nuk e kanë pasur një të tillë.

Nga vendimet gjyqësore rezulton se Gjykatat kanë vlerësuar në tërësi provat dhe e kanë argumentuar vendimin e tyre duke u mbështetur, ndër të tjera, edhe në provat e kontestuara duke i gjetur ato të drejta dhe të marra në përputhje me ligjin procedural.

Nga vlerësimi në tërësi të provave të administruara prej Gjykatave të faktit rezulton se në procesverbalet e datës 29.07.2020 dhe 30.07.2020 e kategorisë “SEKRET” me objekt “Mbi realizimin e përgjimeve të telekomunikimeve” të mbajtur nga Sektori i Përgjimeve të Telekomunikacionit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informatike në Prokurorinë e Përgjithshme janë trajtuar vendimet me nr. 554, datë 09.07.2020, nr. 573, datë 14.07.2020, Nr. 595, datë 20.07.2020, Nr. 603, datë 23.07.2020, Nr. 624, datë 25.07.2020, Nr. 639, datë 28.07.2020, vendim zgjatje afati me nr. 604, datë 24.07.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjithashtu, në dosje rezulton edhe vendimi me nr.595, datë 21.07.2020, i Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çka provon konsistencën dhe vijueshmërinë e veprimeve ligjore të Prokurorisë për përgjimin e personave nën hetim duke rrëzuar kështu pretendimin që nuk ekzistojnë vendime gjyqësore për vleftësim përgjimi dhe vijimin e tij për një afat 15 ditor.

14. Kolegji Penal vlerëson të theksojë se kërkesa për papërdorshmërinë e provave nuk mund të kufizohet vetëm në seancat e vlerësimit të masës së sigurimit personal por është një kërkesë e cila sipas kuptimit të nenit 151 të K. Pr. Penale nuk e humb thelbin e saj të kërimit, kërkim i cili mund të ngrihet çdo gjendje dhe shkallë të procedimit.

15. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se, rekursitet e paraqitura në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 433 të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga personat nën hetim Nejton Bali, Skënder Demiraj, Klaudio Zhilla, Arben Cara, Mimoza Margjeka kundër vendimit me nr. 29, datë 01.10.2020, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 24.12.2020